



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/ 311

Datë: 18.06.2021

Procesverbal

i mbledhjes së II (dytë) të jashtëzakonshme për vitin 2021 e Komitetit për Politikë dhe Financa

REND I DITES

1. Shqyrtimi i miratimi i Raportit të punës nr.02/237 datë: 17.05.2021 të Komisionit Komunal të Aksionarëve për vitin 2020.
2. Shqyrtimi i kërkesës nr.12/82 datë: 06.05.2021 të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
3. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/235 datë: 14.05.2021 të Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronësores-Juridik.
4. Shqyrtimi i kërkesave.
5. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 21.05.2021 duke filluar në ora 13:20, morën pjesë 6 anëtarë të KPF-së, zyra për informim.

Rrahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve për këtë mbledhje Hashim Vrenezi më ka njoftuar që nuk mund të jetë prezent. Për këtë mbledhje kemi edhe disa materiale shtesë, por hapi debat rreth rëndit të ditës.

Alban Krasniqi: Një kërkesë që kanë bërë deputetet e Kuvendit të Kosovës për zyre të trajtohet ajo kërkesë dhe të gjendet një zyre për ta.

Rrahim Morina: Kemi disa kërkesa a jeni që t'i fusim sot dhe t'i trajtojmë në këtë mbledhje? Unanimisht ishin për.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së IV të KPF-së.

Rrahim Morina: Kush jeni për miratimin e këtij procesverbalit? Unanimisht ishin për.

2. Shqyrtimi i miratimi i Raportit të punës nr.02/237 datë: 17.05.2021 të Komisionit Komunal të Aksionarëve për vitin 2020.

Rrahim Morina: Kush jeni për rekomandimin e këtij Raporti? Unanimisht ishin për.

3. Shqyrtimi i kërkesës nr.12/82 datë: 06.05.2021 të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Alban Krasniqi: Është shqetësim dëmtimi i pasurive natyrore dhe të trashëgimisë kulturore, pra është shqetësues dëmtimi i këtyre drunjve edhe nga përdorimi i pesticideve. Të kërkohet një raport nga drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport bashke me listën e të gjitha objekteve kulturore dhe të trashëgimisë natyrore

-Raportin mbi gjendjen e tyre të tanishme, se ndoshta shfuqizimi i atyre vendimeve mos është edhe dorëzimi ynë, pse janë dëmtuar ata drunj, qysh janë dëmtuar, po ashtu edhe gjendja e kullave ekzistuese dhe gjendja e tyre.

Halil Morina: Kjo kërkesë të rekomandohet por ne të kemi një raport të tillë për objektet natyre dhe ato të trashëgimisë kulturore.

Muharrem Morina: Çdo vit drejtorja për Kulturë e ka obligim kështu ka qenë edhe më herët, me pas një listë të freskuar për monumentet natyrore dhe kulturore ekzistuese.

Rrahim Morina: Kush jeni për rekomandimin e kësaj kërkesë? Unanimisht ishin për.

4. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/235 datë: 14.05.2021 të Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronësoro-Juridik.

Rrahim Morina: Ketë temë e kemi trajtuar ne nuk mund të marrim kurrfarë vendimi.

Alban Krasniqi: Atëherë ka qenë konkursi për përfituesit e atyre trojeve, tash nëse dikush e ka marrë të drejtën e shfrytëzimit dhe nëse dëshiron me ja dhënë dikujt tjetër a i plotëson kushtet, sepse kjo nuk është respektuar. Ato troje nëse janë dhënë me te drejt të shfrytëzimit ato s'mund t'i shesin, ne nuk mund ta ndryshojmë bazën ligjore që atëherë e kanë pas.

Rrahim Morina: Ne mund ta udhëzojmë Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronësoro-Juridik që në lidhje me kërkesën e lartcekur të parashtojë kërkesë për konsultim paraprak në Ministrinë për Administrimin e Pushtetit Lokal (MAPL).

5. Shqyrtimi i kërkesave.

Kërkesa nr.02/233 datë: 12.05.2021 të parashtruar nga Këshilli Organizativ Kodra e UÇK-së fshati Ngucat, për përkrahje financiare në Projektin: Kompleksi Kodra e UÇK-së në Ngucat.

Alban Krasniqi: Duhet ta argumentojnë se çka po kërkojnë, e lidhur ke ketë kryetari i Komunës duhet t'i drejtohet Qeverisë me një kërkesë.

Muharrem Morina: Me qenë se titullar është Agjencioni Pyjor tani ne mos po dalim qesharak me marrë vendim.

Alban Krasniqi: Mundet me shku një grup prej qeverisë komunale me trajtu ketë problem me nivelin qendror. Ne s'mund t'i themi nivelit qendror kalone kur ne duke dit që s'janë respektuar procedurat.

Halil Morina: Ata e kanë nisë një punë të mirë, por nuk i kanë respektuar procedurat për atë simbol të luftës.

Valon Krasniqi: Ata nëse e kanë ditë që nuk bënë kështu pse kanë filluar, kjo çështje donë sqarim.

Rrahim Morina: KPF në lidhje me ketë kërkesë nuk ka marrë ndonjë vendim për ndarje të mjeteve financiare, deri sa çështja pronësore për ndërtimin Komplexit Kodra e UÇK-së-Ngucat nuk është në pronësi të Komunës së Malishevës dhe kjo çështje duhet të rregullohet nga Komuna e Malishevës në bashkëpunim me nivelin qendror.

Kërkesa nr.02/231 datë: 12.05.2021 të parashtruar nga Isni Rexhep Morina dhe Ilir Nuhi Morina nga fshati Qypevë Komuna e Malishevës, për ndërrimin e pronës komunale me pronë private.

Rrahim Morina: Kryetari i Komunës në lidhje me kërkesën e lartcekur të bëjë zbatimin e procedurave të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Kërkesa nr.02/205 të datës: 26.04.2021 të parashtruar nga Kryesia e Lagjes Shala – Fshati Mleqan, lidhur me emërtimin e rrugës Apolonia.

Rrahim Morina: Ne i përgjigjemi që pas shqyrtimit të kërkesës se lartcekur të parashtruar këtij organi nuk marrim ndonjë vendim pasi që Komisioni për emërtimin e rrugëve nëpër vendbanime dhe fshatrat e Komunës së Malishevës e ka përfunduar të gjithë procesin lidhur me emërtimet e rrugëve.

Kërkesa nr.02/214 datë: 30.04.2021 të parashtruar nga z.Pajtim Morina nga fshati Llashkadrenoc.

Rrahim Morina: Pas shqyrtimit të kërkesës së lartcekur, përmes kësaj shkrese përcjellëse unanimisht ka kërkuar nga Drejtorja për Shërbime Publike dhe Drejtorja për Mbrojtje dhe Shpëtim, për trajtim të mëtutjeshëm në lidhje me kërkesën në fjalë.

Kërkesa nr.02/174 datë: 12.04.2021 e parashtruar nga zj. Marigona Bytyqi nga fshati Turjakë.

Alban Krasniqi: Unë kërkoj që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend, mirë është me dite a është ndihmuar ndonjë herë nga qeveria.

Rahim Morina: Kush jeni që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/25 datë: 28.01.2021 e parashtruar nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Malishevë.

Rahim Morina: Ne vetë në një takim ju kemi premtuar që do të ju ndihmojmë, kush jeni që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr. 02/243 datë: 20.05.2021 të parashtruar nga Hajrë Mazreku, Januz Mazreku, Selajdin Mazreku dhe Rafet Mazreku nga Maalisheva, për rishqyrtimin e vendimit të Kuvendit të Komunës, për caktimin e lokacionit për varreza të lagjes Hoti në Malishevë.

Rahim Morina: MAPL kish pas kërkuar me shfuqizuar atë vendim tani me sa e dije lënda është në Gjykatë.

Alban Krasniqi: Drejtoria e Urbanizmit e ka për obligim sepse tash gjendja ka ndryshuar e kemi PZHK pra a janë të parapara me PZHK.

Rahim Morina: Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë Komiteti për Politikë dhe Financa nuk ka marrë ndonjë vendim në lidhje me kërkesën në fjalë, pasi që ky rast është në kontest gjyqësor i iniciuar nga palët në Gjykatën Themelore në Malishevë.

Andaj çfarëdo vendimi që merr Gjykata në lidhje me këtë rast në jemi të obliguar ta zbatojmë.

Kërkesa nr.06/99 datë: 21.05.2021 të parashtruar nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronëso-ro-Juridik, për rishqyrtimin e Vendimit nr.02/326 datë: 28.05.2021.

Rahim Morina: Aty ku ka filluar me ndërtuar Bahti Thaqi po kalojke tensioni i rrymës dhe sipas informacioneve aty skish të drejtë ndërtimi dhe tash Inspektorati ja ka ndërprerë punimet.

Alban Krasniqi: Nëse ska drejtë ndërtimi ne s'mundemi mu marrë me këtë çështje.

Rahim Morina: KPF përmes një shkrese përcjellëse e udhëzon drejtorinë që në lidhje me kërkesën e lartcekur të veproni konform ligjeve në fuqi.

Kërkesa nr.02/242 datë: 20.05.2021 e parashtruar nga kryesia e fshatit Carrallukë për caktim lokacioni.

Rahim Morina: Një park në Carrallukë është paraparë me buxhet.

Halil Morina: Nëse fshatra tjera ka problem me kanalizime e ne me nda mjete për park pak jo në rregull.

Rahim Morina: A mund ta rekomandojmë për kuvend për caktim të lokacionit.

Valon Krasniqi: Të trajtohen edhe për fshatrat tjera që janë pas paraparë me buxhet.

Unanimisht ishin të rekomandohet kërkesa e fshatit Carrallukë.

Kërkesa nr.02/240 datë: 17.05.2021 e parashtruar nga zj. Emine Vrenezi, me vendbanim në fshatin Astrazup për mbështetje financiare.

Alban Krasniqi: Kërkesën ne e trajtohem ama me dhanë pare fill pa kontrole nuk mundemi se i kemi 700 familje në asistencë sociale. Drejtoritë munden mi ndihmuar me ndonjë pako ushqimore.

Valon Krasniqi: Për disa kërkesë nuk po ndalemi aq shumë e për disa po i kundërshtojmë.

Alban Krasniqi: Unë jam që familjet që kanë fëmijë nën moshën 15 dhe 18 vjeç e që se kanë njërin prind të ju ndajmë nga 100 euro.

Raimonda Krasniqi: Ka raste sidomos në Terpezë nëna vetushqyese kanë bërë kërkesë sju është ndihmuar personalisht ju kam ndihmuar dhe kanë pas operacione.

Rahim Morina: Kush jeni të ndihmohet me 500 euro? Për ishin 3, kundër s'kishte, abstenime 3 .

Kërkesa e parashtruar nga Shahe Hoti nr.02/245 datë: 21.05.2021.

Alban Krasniqi: Kjo kërkesë nuk është e kompletuar me dokumente mjekësore.

Rahim Morina: Ne mund ta informojmë që duhet të ketë ndonjë dokument nga mjeket e tani kur ka parashtrua kërkesën nuk ka.

Kërkesa nr.02/241 datë: 17.05.2021 e parashtruar nga z. Adem Paçarizi nga fshati Lubizhdë, Komuna e Malishevës, për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor të djali të tij të sëmurë Gazmend Paçarizi.

Rahim Morina: A pajtoheni që te ja ndajmë 900 euro? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr. 02/216 datë: 06.05.2021 e parashtruar nga Zyrafete Gashi.

Alban Krasniqi: Kjo as nuk është banore e Malishevës dhe as ska ndonjë raport të freskët shëndetësor.

Kërkesa nr.02/238 datë: 17.05.2021 e parashtruar nga zj. Shemsije Berisha me vendbanim në fshatin Bardh, Komuna e Malishevës, për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor.

Rahim Morina: Kush jeni që ta ndihmojmë me 500 euro? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/246 datë: 21.05.2021 e parashtruar nga Qëndresa Mazreku nga Malisheva.



Rahim Morina: Lidhur me këtë edhe kërkesë edhe kjo duhet të jetë e pajisur me ndonjë dokument lidhur me terapinë mjekësore.

Rahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve, ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 15:50

Procesmbajtësi

Naim Avdijaj jur. i dip



Kryesuesi i Kuvendit

Naim Morina

